Medikamentet

Detyrimet e importit dhe eksportit bazohen në Tarifën Doganore të Republikës së Shqipërisë. Tarifa Doganore e Republikës së Shqipërisë përfshin - Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave, bazuar në Sistemin e Harmonizuar.

Masat e tjera, të parashikuara nga dispozitat që rregullojnë fusha të veçanta, që kanë të bëjnë me tregtinë e mallrave, zbatohen, kur është e përshtatshme, në përputhje me klasifikimin tarifor të këtyre mallrave.

Per qellime doganore - Medikamentet klasifikohen ne Kreret 3003 dhe 3004 te Nomeklatures se Mallrave (KAPITULLI 30 PRODUKTET FARMACEUTIKE) per te cilat tarifa ne perqindje eshte 0 - Pa takse sipas tabeles https://www.dogana.gov.al/dokument/4323/nomenklatura-2023-vkm-nr883-date-27122022. (faqe 221-225)

Ne deklarimin ne dogane dhe ne Nomeklature nuk ka specifikime per llojin e medikamentit sipas karakteristikave te tij apo principit aktiv. Dogana mund te te identifikoj vetem sasine ne peshe dhe ne vlere statistikore te medikamenteve, bazuar ne deklaratat doganore, por se cfare lloji medikamenti jane eshte ne kompetence te Ministrise se Shendetesise qe ka leshuar Autorizimin:

Ligjit nr. 105/2014 "Per Barnat e sherbimin farmaceutik" i ndryshuar neni 32 sanksionon: Importi i barnave të autorizuara

1. Barnat e autorizuara në Republikën e Shqipërisë importohen nga importuesit e autorizuar nga kompanitë mbajtëse të autorizimit të tregtimit, pas pajisjes me autorizim importi të lëshuar nga Agjencia, në bazë të regjistrit të botuar të barnave.

2. Procedurat doganore kryhen pranë zyrave doganore të hyrjes ku kryhen dhe kontrollet për sigurinë e mbrojtjen dhe, sipas rastit, përfundimi i procedurës doganore mund të bëhet në zyrën doganore të hyrjes apo në një zyrë doganore të brendshme.

3. Verifikimi i barnave të importuara bëhet pranë ambienteve të subjektit, në prani të inspektorit farmaceutik.

Te dhenat e detajuara te kerkuara nga ju, bazuar ne shpjegimet e mesiperme, sugjerojme se disponohen nga Agjensia Kombetare e Barnave dhe Pajisjve Mjekesore e cila leshon Autorizimet per import te barnave te autorizuara si dhe i verifikon ato ne baze te legjislacionit.

Sipas te dhenave te importit DPD disponon statistiken si meposhte vijon:

Viti	P Neto KG	Vlera Statistikore lek
2018	3,541,903	13,391,523,876
2019	5,781,532	20,651,092,938
2020	6,182,987	22,767,850,684
2021	6,012,930	24,229,197,234
2022	5,806,608	24,235,963,880
2023	2,373,382	8,974,610,158